



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

TITULLI I INFORMACIONIT dhe PËRMBAJTJA:

INFORMACION
PËR ZBATIMIN E
STRATEGJISË NACIONALE PËR NDRËMARRJET E VOGLA DHE TË MESME 2018-2023
ME PLAN AKSIONAL 2018-2020

Ky informacion është përgatitur me qëllim të informimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Strategjisë Nationale për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2018-2023 me Plan aksional 2018-2020.

Baza për përgatitjen e këtij informacioni është Konkluzioni nga seanca e gjashtëdhjetë e dy e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të mbajtur më 3.04.2018, me të cilën:

"3. "Ministria e Ekonomisë obligohet që një herë në vit ta informojë Qeverinë për rrjedhën e zbatimit të strategjisë".

Me përgatitjen e Strategjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 2018-2023 ishte përgatitur një PA, por vetëm për periudhën 2018-2020. Në shtojcë të këtij informacioni është edhe Plani Aksional 2018-2020 në të cilin pas çdo aktiviteti në një rresht të veçantë me titull Statusi tregohet se cila është gjendja e një aktiviteti të caktuar me përshkrim të procedurave dhe masave të ndërmarra dhe të realizuara.

Shumica e masave dhe aktiviteteve të përmendura nga Plani Aksional 2018-2020 janë realizuar, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë nisur me realizim, por pandemia e Covid 19 dhe kriza kushtëzon ridrejtimin apo zgjatjen e tyre. Përkatësisht, një pjesë e madhe e aktiviteteve dhe masave të parapara në PA për Strategjinë e NVM-ve dhe në programet vjetore përmes të cilave zbatohet Strategjia, për shkak të Covid-it kriza ose u zgjat ose u fshi, dhe mjetet u drejtuan për mbështetje direkte për ekonominë dhe ndërmarrjet, për të cilat Qeveria miratoi gjashtë paketa masash ekonomike.

Në vazhdim Ministria e Ekonomisë përmbledh zbatimin e aktiviteteve të mëposhtme nga Plani Aksional 2018-2020 i Strategjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Lidhur me **SHTYLLA 1: Mjedisi i volitshëm afarist**, Programi 1.1.: Përmirësimi i politikëbërjes dhe koordinimit është formuar Trupi Koordinues për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë, por për shkak të pandemisë Covid 19, takimet formale të anëtarëve të ministrive dhe institucioneve të veçanta nuk janë mbajtur në dy vitet e fundit.

Në vazhdimësi përkraket Agjencia për Mbështetje të Sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (AMSRMV) dhe rritet buxheti për realizimin e aktiviteteve të saj programore.

Lidhur me Programin 1.2: Thjeshtëzimi i mjedisit juridik dhe rregullator pas marrjes së rekomandimeve nga Indeksi i Politikës së NVM-ve 2022, respektivisht Raporti mbi Aktin e Ndërmarrjeve të vogla për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, i cili do të publikohet në vitin 2022, do të fillojë të shqyrtojë mundësinë dhe aktivitetet për futjen e "testit të NVM-ve".

Me ndryshimet e ligjit të falimentimit, i cili po zbatohet si projekt i financuar nga Banka Botërore, do të prezantohet koncepti i paralajmërimit të hershëm për kompanitë.

Zbatimi i Strategjisë për formalizimin e ekonomisë informale 2018-2022 vijon përmes realizimit të planeve aksionale dyvjeçare dhe fushatës së vazhdueshme edukative dhe informative publike për të ofruar mbështetje të gjerë për formalizimin e ekonomisë informale.



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me qëllim të uljes së shpenzimeve për start-ap kompanitë, janë miratuar ndryshimet në Ligjin për shoqëritë tregtare në pjesën e themelimit të një sipërmarrje me bazë 1 euro dhe ndryshimet për lehtësimin e procedurës për formimin e sipërmarrjes me kredi të konvertueshme janë në procedurë parlamentare.

Për Programin 1.3.: Forcimi dhe institucionalizimi i dialogut social, është nënshkruar Memorandum për dialog publik-privat ndërmjet katër odave ekonomike dhe Qeverisë, ndërsa uebfaqja biznisregulativa.mk përditësohet çdo ditë me të dhënat më të fundit relevante për sektorin e biznesit. Nëpërmjet “Strategjisë për Gratë Sipërmarrëse 2019-2023” dhe “Platforma Kombëtare për Sipërmarrjen e Grave” sigurohet përfshirja edhe e grave në këtë dialog. Mekanizmi i Dialogut Social është përmirësuar me formimin e Komisionit Qeveritar për Dialog Publiko-Privat, i përbërë nga ministra, i kryesuar nga Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Ekonomike.

Programi 1.4. Përmirësimi i koordinimit në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të NVM-ve dhe monitorimi dhe vlerësimi i NVM-ve vazhdon të zbatohet duke përgatitur dhe publikuar një raport vjetor mbi Raportin e Observatorit të NVM-ve për AMSRMV si dhe duke përpunuar të dhënat e marra nga Regjistri Qendror (RQRMV). Përfaqësimi i sektorit të NVM-ve është rritur edhe me formimin e Komisionit qeveritar për Dialog Publiko-Privat.

Lidhur me SHTYLLA 2: Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM-ve, Programi 2.1.: Përmirësimi i shërbimeve të zhvillimit afarist realizohet përmes përgatitjes së raporteve për zbatimin e programeve vjetore si nga Ministria e Ekonomisë ashtu edhe nga AMSRMV; Identifikimi dhe promovimi i praktikave të mira në zhvillimin e NVM-ve realizohet në mënyrë decentrale përmes instrumenteve të AMSRMV dhe përmes rrjetit infrastrukturor të 7 Qendrave Rajonale. Konsultimet me ofruesit e shërbimeve të zhvillimit të NVM-ve zbatohen përmes aktiviteteve të programit të AMSRMV, si më poshtë: Sistemi i vauçerëve të këshillimit të subvencionuar (në të cilin aktorë janë Organizatat për Mbështetjen afariste dhe konsulentët), Info pult, shërbimet e mentorimit që realizohen përmes rrjetit institucional të qendrave rajonale të mbështetjes së NVM-ve, si dhe përmes shpalljes publike të raporteve vjetore, mbi realizimin e aktiviteteve programore, si dhe përmes deklaratave të kënaqësisë nga shërbimi (sistemi këshillues për vauçerë), deklaratat e cilësisë së shërbimit të marrë (shërbimet mentoruese për NVM-të), në të cilat aktivitetet programore marrin pjesë edhe gra sipërmarrëse.

Përmes faqes konkurentost.mk kompanitë lehtë dhe thjesht mund të marrin të gjitha informatat lidhur me aspekte të ndryshme të punës së tyre, mundësitë për mbështetje financiare dhe jofinanciare nga programet/projektet buxhetore apo projektet e donatorëve (Programe, Projekte, Masa, Thirrje Publike, Trajnime, Linjat e kreditit, Të bërit biznes, Ligjet ...).

Gjithashtu, të rinjtë si target grup janë të përfshirë në disa aktivitete programore të AMSRMV-së, përkatësisht në Programin e Vetëpunësimit, përmes programit të shërbimeve mentoruese për ndërmarrjet fillestare, si dhe shërbimeve këshilluese me mbështetjen e programit të vauçerëve të shërbimeve këshillimore.

Rreth programit 2.2. Përmirësimin të qasjes në financa, Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut (BZHMV) zbaton faktoringun si shërbim që mundëson shitjen e produkteve dhe shërbimeve me pagesë të shtyrë, ndërsa me plotësimin e Ligjit për BZHMV, brenda të njejtës u krijua Fondi i Garancisë si një njësi e veçantë organizative dhe Skema e Garancisë Kreditore u rivitalizua si pjesë e grupeve të masave ekonomike të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për trajtimin e pasojave nga pandemia KOVID-19 e cila është pjesë të Planit të Rritjes së Përshpejtuar dhe Zhvillimit të Qeverisë.

Me qëllim të avancimit të edukimit financiar si të kompanive ashtu edhe të popullatës, është përgatitur "Strategjia për edukim financiar dhe përfshirje financiare 2021-2025", ndërsa Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Financave në vazhdimësi realizojnë fushata edukative për të arritur te të gjitha segmentet e shoqërisë.



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lidhur me Programin 2.3. Lehtësimi i Ndërkombëtarizimit dhe Programi 2.4. Mbështetje për zhvillimin e zinxhirit të vlerës Ministria e Ekonomisë informon se ka përfunduar prokurimi publik dhe është përzgjedhur një operator ekonomik që do të punojë në përgatitjen e "Strategjisë së promovimit të Eksportit 2022-2026". Ajo do të përmbajë analiza të shumta, duke përfshirë tregtinë e jashtme dhe zhvillimin e strukturës së eksportit sipas sektorëve, sektorëve potencialë të eksportit, burimeve potenciale të financimit dhe të ngjashme.

Një nga rezultatet e pritshme të "Strategjisë së promovimit të Eksportit 2022-2026" është krijimi i një kornize strategjike dhe plan aksional për të mbështetur ndërkombëtarizimin e kompanive, dhe në konsultim dhe dialog me institucionet e interesuara dhe palët, respektivisht forcimi i bashkëpunimit të partneritetit ndërmjet të gjitha agjencive dhe institucioneve.

Në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të NVM-ve në sektorin e TIK-ut, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës ka përgatitur një draft "Strategjia nacionale për TIK" me një Plan Aksional dhe e njehta është në proces miratimi.

Poashtu ekziston edhe një plan për dixhitalizimin e regjistrave dhe shërbimeve elektronike në kuadër të projektit të financuar nga IPA 2017 që duhet të çojë në ndërveprueshmërinë e institucioneve, me qëllim të lehtësimit të funksionimit të ndërmarrjeve.

Për sa i përket mbështetjes së zhvillimit të NVM-ve në ekonominë e gjelbër përmes reformave të politikave kombëtare dhe hartimit të instrumenteve dhe shërbimeve mbështetëse, në Programin e Konkurrueshmërisë, Inovacionit dhe Sipërmarrjes për vitin 2021, të zbatuara nga Ministria e Ekonomisë, ndër të tjera, janë zbatuar disa masa për këtë mbështetje: për prokurimin dhe instalimin e paneleve fotovoltaike - sistem i mbyllur; për analizën eksperte dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko-projekt ose studimit teknik të fizibilitetit për: përgatitjen e ndërmarrjes për rritjen e efikasitetit energjetik, futjen e konceptit të ekonomisë rrethore dhe ekonomisë së gjelbër; për përgatitjen e dokumentacionit të projektit për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe prokurimin, zbatimin, certifikimin dhe trajnimin për standardet në fushën e: standardeve horizontale (MKC EN ISO 50001; MKC EN; ISO 9001; ISO 14001 ; ISO 22000; MKC EN ISO 45001; MKC EN ISO 31000); të harmonizuara dhe të tjera standarde dhe dokumente standardizimi në fushën e industrisë përpunuese.

Rreth SHTYLLA 3: Ekosistemi Dinamik i Sipërmarrjes dhe Inovacionit dhe Programi 3.1. Zgjerimi i sipërmarrjes në arsim dhe trajnim Mund të themi se sipërmarrja si lëndë është e përfaqësuar pothuajse në të gjitha nivelet e arsimit formal, edhe atë në arsimin e mesëm në kuadër të lëndëve "Biznes dhe Sipërmarrje", dhe në nivelin e arsimit të lartë në programet mësimore për menaxhim të kompanive, gjegjësisht Menaxhim Biznesi.

Në aspektin e sipërmarrjes sociale, në dekadën e fundit organizatat e shoqërisë civile kanë qenë shumë aktive në ngritjen e vetëdijes për sipërmarrjen sociale dhe kanë zbatuar programe të shumta të edukimit joformal në këtë temë në fushën e arsimit joformal. Iniciativa të tilla u mbështetën edhe nga institucione të caktuara.

Për vendosjen e partneriteteve të reja ndërmjet institucioneve arsimore dhe industrisë, përveç AMSRMV dhe Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT) realizon aktivitetet e tij gjatë Thirrjes Publike për instrumentin "Grante të bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve", ofroi ekspertizë falas në fushat e mëposhtme: Menaxhimi i Inovacionit, Analiza e Tregut, Përgatitja e propozim projektit dhe Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe në vitin 2019 për thirrjen publike për instrumentin "Grante të bashkëfinancuara për zhvillimin teknologjik" ku FIZHT ofroi gjithashtu ekspertizë falas në fushat e mëposhtme : Analiza e Tregut, Përgatitja e propozim projektit dhe Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale. Njëherësh, në fund të vitit, FIZHT shpalli thirrjen "Startupujaj2" për instrumentin Grante të bashkëfinancuara për shoqërite tregëtare të reja start-up dhe spin-of, për të cilat gjithashtu ofron ekspertizë falas në fushat: Menaxhimi Inovacionit, Analiza e Tregut. Përgatitja e propozim projektit dhe Mbrojtja e të



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

drejtave të pronësisë intelektuale., FIZHT gjithashtu zbaton vauçerin inovativ.

Për Programin 3.2: Përmirësimi i shkencës, teknologjisë dhe inovacioneve në zhvillimin e NVM-ve mund të theksojmë se buxheti i FZHT është në rritje të vazhdueshme, e në këtë mënyrë edhe shtrirja e NVM-ve të mbështetura në aspektin e projekteve inovative. Në kuadër të procesit të eksplorimit të mundësive për zgjerimin e rrjetit të engjëjve të biznesit dhe hartëzimit të përdorimit të engjëjve nga investitorët në sektorin e NVM-ve, u përgatit një "Studim për stimulimin e tregut informal të kapitalit me rrezik nëpërmjet promovimit të modelit të engjëjve të biznesit" si bazë për përkufizimin dhe krijimin e masave inkurajuese.

Për të inkurajuar bashkëpunimin midis shkencës dhe biznesit, FIZHT realizon Vauçerin e Inovacionit, nëpërmjet të cilit ofrohet stimul i drejtpërdrejtë financiar që kompanitë e përdorin për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për shërbimet të cilat i ofrojnë institucionet akademike dhe kërkimore. FIZHT aktualisht është duke punuar në zhvillimin e një skeme për bashkëpunim ndërmjet industrisë dhe akademisë.

Në drejtim të realizimit të Programit 3.3. Krijimi i parqeve shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorëve për inovacione njoftojmë se Ministria e Ekonomisë në vitin 2018 përmes zbatimit të njëres nga masat e programit vjetor financoi projektin e dorëzuar duke lidhur kontratë për realizimin e projektit me të cilin financohet Parku i ri Teknologjik në kuadër të Universitetit "Nënë Tereza" Shkup.

Gjithashtu, me iniciativë të Qeverisë u formua Parku i Shkencës dhe Teknologjisë, i cili zbatohet nga FIZHT dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Deri më tani është realizuar faza e parë, ndërsa në fazën e dytë dhe të tretë është paraparë ndërtimi i objekteve dhe laboratorëve të rinj, të cilët do të përfundojnë deri në vitin 2024, saktësisht në vitin 2027. Studimi mbështetet financiarisht nga Delegacioni i BE-së.

Lidhur me iniciativën për hapjen e akselatorëve, informojmë se FIZHT ka mbështetur financiarisht ngritjen dhe funksionimin e 3 akcelatorëve operacionalë në vend: X Factors, Seavus dhe akcelatorë të UKIM . X Factors dhe Seavus janë akcelatorë privatë, ndërsa akcelatori UKIM ka një model partneriteti ku UKIM është një nga pronarët. Qëllimi i këtij akcelatori është të identifikojë dhe mbështesë zhvillimin e sipërmarrësve më perspektiv, start-up dhe kompanive që janë në fazën fillestare të zhvillimit dhe kanë potencial të fortë tregtar dhe tregu.